



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.89/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afiete Sada anëtarë, me zyrtares e lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Novica Marković nga Komuna e Graçanicës, paraqitur kundër subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS), me seli në Graçanicë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në objekt privat, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Novica Marković, nga Graçanica, dhe subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS), me seli në Graçanicë i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1,200.00 (njëmijë dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 05.06.2017, nga Novica Marković, pronar i objektit (trafikës) i cili gjendet në Graçanicë, pretendon se në magjistralen Prishtinë-Gjilan, në rrugën Knez Lazar pn., pjesëtarët e subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS), gjatë natës, pa pëlqimin e tij dhe pa lejen e tij i ka vendosur materialet zgjedhore në objektin e tije

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, kandidatët dhe simpatizantët e tyre, neni 33 paragraf 1 pika b të LZP-së nr.003/L-073.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të objektit ku janë vendosur materialet zgjedhore.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.06.2017, ka theksuar se pas pranimit të kërkesës nr.89/2 të datës 06.06.2017, i cili ka të bëjë me parashtrimin e ankesës Anr.89 lidhur me shkeljen e dispozitave të nenin 4 paragraf 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 Kodit të Mirësjelljes për SP, kandidatët dhe simpatizantët e tyre, dhe nenit 33 paragraf 1 pika b) LZP-së nr.03/L-073, duke vepruar sipas urdhrit për ndërmarrjen e masave konkrete lidhur me ankesën Anr.89, Progresivna Demokratska Stranka (PDS) ka URDHËRUAR aktivistëve të saj që pa asnjë vonesë të largojnë materialet zgjedhore nga trafika e pronarit Novica Markovic, e cila gjendet në magjistralen Prishtinë – Gjilan, në rrugën e Knez Lazarit pn.

Lidhur me veprimet e ndërmarra për ti evituar shkeljet e pretenduara në ankesë, përgjigjes në ankesë iu është bashkangjitur, njoftimin për Kodin e mirësjelljes, të miratuar dhe të dorëzuar

anëtarëve dhe kandidatëve të PDS si dhe dëshmi fotografike për ndërmarrjen e masave konkrete.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se materiali zgjedhor i subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS) janë vendosur në objekt privat, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, hapsirat private pa lejen e pronarëve dhe shfrytëzuesve*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik PDS ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti se materiali zgjedhor nga ky subjekt politik është vendosur në objekt privat (trafik). Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr materialin zgjedhor nga objekti privat (trafika) - në vendin e palejuar, edhe pse nuk kanë ofruar asnjë foto si dëshmi që kanë bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.89/2017 më datën 07.06.2017.



### ***Këshilla Juridike:***

*Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.*